



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 497/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 4.11.2020 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Modifikimi i dokumentave standarte të procedurës së prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF-73393-09-29-2020, me objekt “*Blerje bukë gruri për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve*”, me fond limit 166.020.047 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 23.10.2020, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara.

Ankimues: “Kadra” sh.p.k.
Rruga “Nënë Tereza”, Laknas, Tiranë

Autoriteti Kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara
Sheshi “Skënderbej”, Nr. 3, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 30.09.2020 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me nr. REF-73393-09-29-2020, me objekt “Blerje bukë gruri për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve”, me fond limit 166.020.047 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 23.10.2020, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara”.

II.2. Në datën 05.10.2020 dhe në datën 06.10.2020 operatori ekonomik “Kadra” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit me argumentat si më poshtë:

[...]

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të publikuar për procedurën e sipërpërmendur dhe duke shqyrtuar kriteret e veçanta të vendosura nga autoriteti kontraktor kemi një sërë faktesh për vendosjen e një kriteri jo të bazuar në ligj, më konkretisht pika 8, kriteret e veçanta në DST.

Pretendimet tona në lidhje me këtë kriter janë si më poshtë përmendur:

Pika 1

Kriteri i mësipërm i vendosur në DST si kusht për plotësimin nga operatorët ekonomikë i është referuar pikës 8 të nenit 27 të VKM –së nr. 914, datë 29.12.2014, i cili thotë si më poshtë:

8. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ndalohet të kualifikojë operatorët ekonomikë, që sipas LPP janë fitues dhe/apo kanë në proces, në të njëjtën kohë, si kontraktorë/nënkontraktorë sipas një kontrate apo kontratave të lidhura a në proces për t'u lidhur, për furnizimin/blerjen e ushqimeve të freskëta në subjekte të tjera shtetërore të cilat në çastin e hapjes së ofertave nuk i ka përfunduar kontratat në masën 70%. Përcaktimi i mësipërm vlen edhe për rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ku secili prej tyre, për t'u kualifikuar duhet të ketë përfunduar kontratat në masën 70% të vëllimeve të përgjithshme të furnizimeve, që ai ka marrë përsipër të realizojë, në përputhje me kontratën e bashkëpunimit.

Në vitin 2018 me vendim nr. 81 datë 14.02.2018, i cili mban firmën e kryeministrit, është krijuar një institucion i ri i quajtur Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara. Nëpërmjet këtij ligji vendoset krijimi, organizimi dhe funksionimi i këtij institucioni.

Po në vitin 2018 me vendimin nr. 82, datë 14.02.2018 i cili gjithashtu mban firmën e kryeministrit është përcaktuar kompetenca dhe procedurat e prokurimeve që kjo agjenci mund të zhvillojë, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të varësisë, për disa mallra dhe shërbime.

Pra që nga krijimi dhe vënia në funksion e Agjencisë së Blerjeve të Përqëndruara, prokurimeve me vlera mbi kufirin monetar kryhen nga ky institucion.

Më konkretisht që nga hyrja në fuqi e vendimeve nr. 81 dhe 82 të datës 14.02.2018, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve nuk kryen më procedura prokurimi që kanë vlerë mbi kufirin monetar. Në kompetencat e Agjencisë së Blerjeve të Përqëndruara është vendosur dhe pika 1.22 e vendimit nr. 82 datë 14.02.2018 Blerje artikuj ushqimorë.

Duke marrë shkas nga kriteri nr. 8 në DST, i cili i është referuar pikës 8 të nenit 27 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 mendojmë që ky kriter nuk qëndron pasi kjo pikë është specifikisht e përcaktuar për institucionin Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve pra ka qenë e bërë për periudhën kur Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve i kryente vetë procedurat e prokurimeve për ushqimet por nga viti 2018 bazuar në vendimet nr. 81 dhe 82 të datës 14.02.2018 këtë kompetencë e ka marrë Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara. Duke qenë që pika 8 është specifikuar për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve nuk mendojmë që Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara mund të implementojë një direktivë dhe një pikë ligjit për prokurimet publike që është i adresuar për një institucion tjetër të cilin as nuk e ka në varësi. Pra vendosja e këtij kriteri nga Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara nuk mund të bëhet duke i vënë referencë ligjore një ligj që i drejtohet një institucioni tjetër. Në momentin që tenderin e organizon, menaxhon dhe kryen të gjitha procedurat ligjore për shpalljen në sistem, hapjen për oferta, kualifikimet dhe skualifikimet e operatorëve, pranimin e ankesave dhe kthimin e përgjigjeve të ankesave nga operatorët, shpalljen e fituesit dhe të gjitha procedurat me radhë i kryen Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara, atëherë Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve nuk ka asnjë kompetencë në një procedurë të organizuar nga ABP, nuk mundet që ky ligj të implementohet si kriter. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të cilës i referohet ligji nuk ka asnjë kompetencë për kualifikimin ose skualifikimin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë ku organizator i procedurës është Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara.

Në momentin që Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve nuk është më autoritet kontraktor atëherë dhe pika 8 e nenit 27 të VKM 914, datë 29.12.2014 bie dhe mund të implementohet vetëm kur ky institucion ti organizojë vetë procedurat e prokurimeve publike më konkretisht për blerjen e artikujve ushqimorë.

Pika 2

Vendosja e këtij kriteri në këtë vit të kushtëzuar nga pandemia e shkaktuar nga virusi Covid 19 është mjaft diskriminuese, sepse për një periudhë 3 mujore i gjithë vendi ka qenë në izolim dhe realizimi i kontratave ka qenë i pamundur. Bazuar në faktin që të gjitha kontratat që mund të kenë lidhur operatorët për ushqime të freskëta me subjekte shtetërore siç është cituar në pikën 8 të kriterëve të veçanta të vendosura në DST, janë kryesisht me institucione të shkollore si konvikte, kopshte, çerdhe të cilat për një periudhë gati 3 mujore kanë qenë të mbyllura me urdhër dhe vkm më saktë:

- 1- Urdhër nr. 135/1 datë 09.03.2020 i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për mbylljen e veprimtarisë së çerdheve për kufizimin e përhapjes së infeksionit Covid 19”*
- 2- Urdhër nr. 156 datë 10.03.2020 i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për marrjen e masave të veçanta për parandalimin e infeksionit të shkaktuar nga Covid 19”*
- 3- VKM nr. 243, datë 24.03.2020 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”.*

Pra nisur nga urdhërat e sipërcituar dhe nga VKM e sipërpërmendur vendi ka qenë në një izolim total dhe janë ndaluar të gjitha aktivitetet që lidhen me çerdhet, kopshtet, shkollat pra rrjedhimisht është ndaluar dhe realizimi i kontratave me institucionet shtetërore. Kjo ka bërë që kontratat të mosrealizohen në përqindjen e duhur.

Nisur nga të gjitha faktet e parashtruara dhe dokumentacionin e bashkangjitur kësaj ankese, pretendojmë se vendosja e këtij kriteri është diskriminues bazuar dhe në nenin 20 “Mosdiskriminimi” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

Me vendosjen e këtij kriteri bëhet e mundur favorizimi i operatorëve të caktuar dhe në këtë mënyrë paracaktimi i fituesit. Kjo gjë është në shkelje të hapur me të gjitha ligjet e prokurimeve publike dhe konkurrencës së ndershme midis operatorëve ekonomikë.

Për sa më sipër argumentuam në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, dhe DST kërkojmë:

- 1. Së pari, nisur nga të gjitha argumentat dhe faktet e paraqitura më lart, kërkojmë nga ana e autoritetit kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara heqjen e pikës 8 të kriterëve të veçanta pasi është në kundërshtim të plotë me nenin 20 “Mosdiskriminimi” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, dhe është në kundërshtim me VKM sepse vetëm ajo pikë është në fuqi kur Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve është autoritet kontraktor.*

2. Së dyti, nëse autoriteti kontraktor i qëndron kërkesës së saj duhet të argumentojë kundërshtimin me VKM si dhe të shpjegojë operatorët ekonomikë nëse në rastin e pandemisë dhe izolimit do të konsiderohet kontratat e realizuar periudha në të cilën nuk është ofruar furnizim për autoritete përkatëse, kjo e vërtetuar më vërtetime të lëshuara nga autoritete përkatëse sipas të cilave kontrata nuk është realizuar si pasojë e pandemisë dhe mbylljes së institucioneve nga shpallja e gjendjes së fatkeqësisë natyrore bazuar në VKM nr. 243, datë 24.03.2020 “Për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme”.

II.4. Në datën 08.10.2020, me shkresën nr. 2004/3 prot., operatori ekonomik ankimues është vënë në dijeni në lidhje me kthimin e përgjigjes nga autoriteti kontraktor ku ankesa nuk është pranuar.

Autoriteti kontraktor konkretisht në kthimin e përgjigjes argumenton se:

[...]

Kriteri në shtojcën 9 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, seksioni 2.3. “Kapaciteti teknik”, pika 8, është vendosur në zbatim të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27, “Kontratat e mallrave”, pika 8, në të cilin parashikohet se: “Drejtoria e Përgjithshme e Blerjeve ndalohet të kualifikojë operatorët ekonomikë, që sipas LPP, janë fitues dhe/apo kanë në proces, në të njëjtën kohë, si kontraktorë/nëkontraktorë sipas një kontrate apo kontratave të lidhura a në proces për t’u lidhur, për furnizimin/blerjen e ushqimeve të freskëta në subjekte të tjera shtetërore, të cilat në çastin e hapjes së ofertave nuk i ka përfunduar kontratat në masën 70%. Përcaktimi i mësipërm vlen edhe për rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ku secili prej tyre për t’u kualifikuar duhet të ketë përfunduar kontratat në masën 70% të vëllimeve të përgjithshme të furnizimeve, që ai ka marrë përsipër të realizojë, në përputhje me kontratën e bashkëpunimit”.

Në vendimin nr. 82, datë 14.02.2018 “Për ngarkimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqëndruara për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të kryeministrit, ministrive dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra dhe shërbime”, i ndryshuar, përcaktohet si vijon: “Ngarkimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqëndruara si organ qendror blerës, për prokurimin e fondeve buxhetore, me vlerë mbi kufirin monetar të prokurimeve me vlera të vogla në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrive, institucioneve në varësi të Kryeministrit e të ministrive të linjës, për blerjen e mallrave dhe të shërbimeve, si më poshtë vijon: ...1.22 Blerje artikuj ushqimorë...”.

Në pikën 7 të vendimit nr. 82, datë 14.2.2018 përcaktohet se: “Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara duhet të prokurojë, nëpërmjet marrëveshjes kuadër, mallrat dhe shërbimet e vazhdueshme dhe/ose të unifikuara. Kategoritë konkrete të mallrave dhe shërbimeve, të cilat do të prokurohen nëpërmjet marrëveshjes kuadër, përcaktohen sipas udhëzimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik.

Në këtë rast Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara ka këto detyra dhe përgjegjësi: a) Të zhvillojë procedurat e prokurimit deri në nënshkrimin e marrëveshjes kuadër; b) Të përlllogaritë fondin limit për mallrat dhe shërbimet që do të prokurohen; c) Të shqyrtojë ankesat e operatorëve ekonomikë deri në shpalljen e njoftimit të operatorëve të suksesshëm.

Në Vendimin nr. 400 datë 14.5.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 82 datë 14.2.2018 të Këshillit të Ministrave “Për ngarkimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqëndruara për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të kryeministrit, ministrave dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra dhe shërbime”, në pikën 6 përcaktohet si vijon: “Në pikën 7 bëhen këto ndryshime dhe shtesa: a) shkronja “b” dhe “c” ndryshohen si më poshtë vijon: b) Të përllongaritë fondin limit për sasi të pritshme të mallrat dhe shërbimet që do të prokurohen, bazuar në kërkesa, afatin e marrëveshjes kuadër dhe fondin limit të dërguar nga autoritetet kontraktore. c) Të shqyrtojë ankesat e operatorëve ekonomikë. b) pas shkronjës “c” shtohen shkronjat “ç” “d” dhe “dh” me këtë përmbajtje: ç) të bashkërendojë punën me autoritetet kontraktore, për mbledhjen e përpunimi e të dhënave teknike e sasiore, të mallrave dhe shërbimeve të vazhdueshme dhe/ose të unifikuara; d) të verifikojë përputhshmërinë e kërkesave të dërguara nga autoritetet kontraktore, me legjislacionin dhe standartet në fuqi, dh) të njoftojë autoritetet kontraktore që të lidhin një ose disa kontrata, sipas nevojave të tyre, brenda afatit dhe fondit të përcaktuar në marrëveshjen kuadër”.

Në dokumentat e tenderit, në “Njoftimin e kontratës”, në pikën 2.7. “Autoriteti kontraktor/Autoritetet kontraktore të cilat do të lidhin marrëveshjen kuadër”, përcaktohet: “Organi qendror blerës në emër dhe për llogari të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve Tiranë”.

Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik sqarojmë se autoriteti kontraktor përfitues dhe me të cilin do të lidhet kontrata/kontratat do të jetë Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

[...]

Organi qendror blerës ka vendosur kriterin në zbatim të nenit 27 pika 8 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar në të cilin është përcaktuar qartë se për autoritetin kontraktor Drejtoria e Përgjithshme të Burgjeve lidhur me mallrat objekt prokurimi të ndalohet të kualifikohen operatorët ekonomikë që janë fitues dhe / apo kanë në proces, në të njëjtën kohë si kontraktorë sipas një kontrate apo kontratave të lidhura a në proces për t’u lidhur, për furnizimin /blerjen e ushqimeve të freskëta në subjekte të tjera shtetërore, të cilat në çastin e hapjes së ofertave nuk i ka përfunduar kontratat në masën 70 %. Gjithashtu për organin qendror blerës është e rëndësishme shmangia dhe evitimi i problemeve që mund të hasen me furnizimet e artikujve të cilat mund të lindin nga mosrealizimi me sukses i kontratave të tjera që operatori ekonomik mund të ketë në proces gjatë realizimit të kontratës objekt prokurimi. Deklarimi i pasjes ose jo të kontratave në proces është kërkuar për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës, të cilët në çdo rast, duhet të plotësojnë deklaratën nën përgjegjësinë e tyre mbi pasjen ose jo të kontratave në proces.

Sa më sipër operatori ekonomik duhet të dorëzojë vetëdeklarimin duke deklaruar që aktualisht nuk ka kontrata të realizuara në masën nën 70% në mënyrë që autoriteti kontraktor t’i lindë e drejta e verifikimit mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik.

II.5. Në datën 14.10.2020, operatori ekonomik ankimues ka depozituar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke ngritur të njëjtat pretendime si edhe në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.5. Me shkresën me nr. 2134/1 prot, datë 26.10.2020, protokolluar me tonën me nr. 1279/2 prot, datë 28.10.2020, me objekt “Dërgim dokumentacioni dhe informacioni për procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje bukë gruri për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve”, është depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e ngritur nga ankimuesi “Së pari, nisur nga të gjitha argumentat dhe faktet e paraqitura më lart, kërkojmë nga ana e autoritetit kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara heqjen e pikës 8 të kriterëve të veçanta pasi është në kundërshtim të plotë me nenin 20 “Mosdiskriminimi” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, dhe është në kundërshtim me VKM sepse vetëm ajo pikë është në fuqi kur Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve është autoritet kontraktor”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 9, pika 2.3. Kapaciteti teknik, pika 8, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin: “Operatori ekonomik pjesëmarrës i cili sipas LPP-së, është fitues dhe/apo ka në proces, në të njëjtën kohë, si “ontraktorë/nënkontraktorë sipas një kontrate apo kontratave të lidhura a në proces për t’u lidhur, për furnizimin/blerjen e ushqimeve të freskëta në subjekte të tjera shtetërore, të cilat në çastin e hapjes së ofertave nuk i ka përfunduar kontratat në masën 70%, bazuar në pikën 8 të nenit 27 të VKM-së nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar, nuk kualifikohet për këtë procedurë prokurimi. Përcaktimi i mësipërm vlen edhe për rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ku secili prej tyre, për t’u kualifikuar duhet të ketë përfunduar kontratat në masën 70 % të vëllimeve të përgjithshme të furnizimeve, që ai ka marrë përsipër të realizojë, në përputhje me kontratën e bashkëpunimit.(sipas pikës 8 të nenit 27 të VKM-së nr.914 datë 29.12.2014).

Për të provuar këtë:

- a) Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë **vetdeklarim**, në formatin e tabelës së mëposhtme, ku të deklarojë të gjitha procedurat e prokurimi për të cilat sipas LPP deri në **çastin e hapjes së ofertave** është shpallur fitues si dhe kontratat e lidhura a në proces për t’u lidhur, **për furnizimin/ blerjen e ushqimeve të freskëta në subjekte të tjera shtetërore, të cilat në çastin e hapjes së ofertave nuk i ka realizuar në masën 100%**. Përcaktimi i mësipërm vlen edhe për rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ku secili prej tyre, duhet të vetdeklarojë të gjitha procedurat e prokurimi për të cilat sipas LPP është shpallur fitues deri në çastin e hapjes së ofertave si dhe të gjitha kontratat e lidhura a në proces për t’u lidhur, për furnizimin/ blerjen e ushqimeve të freskëta në subjekte të tjera shtetërore, të cilat nuk i ka realizuar kontratat në masën 100 % të vëllimeve të përgjithshme të furnizimeve, që ai ka marrë përsipër të realizojë, në përputhje me kontratën e bashkëpunimit.

Nr.	Autoriteti kontraktor, i cili e ka shpallur fitues dhe/ apo me të cilin ka në proces marrëveshje kuadër / kontratë të lidhur a në proces për t'u lidhur.	Objekti i procedurës së prokurimit/ marrëveshjes kuadër / kontratës, për të cilën është fitues dhe/apo ka në proces, në të njëjtën kohë, si kontraktor/ nënkontraktor sipas një marrëveshje kuadër / kontratë të lidhur a në proces për t'u lidhur.	Vlera e shpallur fituese / e kontraktuar / e nënkontraktuar.	Përqindja e vlerës së realizuar / përfunduar, deri në ditën e hapjes së ofertave.
1				
2				

b- Në rast se operatori ekonomik pjesmarrës /seicili nga pjestarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë, nuk është/janë në kushtet e përcaktuara në germen a) të kësaj pike ta deklarojë këtë fakt nëpërmjet vetdeklarimit të tij/tyre.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik.

III.1.2. Autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes drejtuar operatorit ekonomik ankimues për trajtimin e ankesës sqaron se:

Kriteri në shtojcën 9 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, seksioni 2.3. “Kapaciteti teknik”, pika 8, është vendosur në zbatim të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27, “Kontratat e mallrave”, pika 8, në të cilin parashikohet se: “Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ndalohet të kualifikojë operatorët ekonomikë, që sipas LPP, janë fitues dhe/apo kanë në proces, në të njëjtën kohë, si kontraktorë/nënkontraktorë sipas një kontrate apo kontratave të lidhura a në proces për t'u lidhur, për furnizimin/blerjen e ushqimeve të freskëta në subjekte të tjera shtetërore, të cilat në çastin e hapjes së ofertave nuk i ka përfunduar kontratat në masën 70%. Përcaktimi i mësipërm vlen edhe për rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ku secili prej tyre për t'u kualifikuar duhet të ketë përfunduar kontratat në masën 70% të vëllimeve të përgjithshme të furnizimeve, që ai ka marrë përsipër të realizojë, në përputhje me kontratën e bashkëpunimit”.

Në vendimin nr. 82, datë 14.02.2018 “Për ngarkimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqëndruara për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të kryeministrit, ministrive dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra dhe shërbime”, i ndryshuar, përcaktohet si vijon: “Ngarkimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqëndruara si organ qendror blerës, për prokurimin e fondeve buxhetore, me vlerë mbi kufirin monetar të prokurimeve me vlera të vogla në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrive, institucioneve në varësi të Kryeministrit e të ministrive të linjës, për blerjen e mallrave dhe të shërbimeve, si më poshtë vijon:...1.22 Blerje artikuj ushqimorë...”.

Në pikën 7 të vendimit nr. 82, datë 14.2.2018 përcaktohet se: “Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara duhet të prokurojë, nëpërmjet marrëveshjes kuadër, mallrat dhe shërbimet e vazhdueshme dhe/ose të unifikuara.

Kategoritë konkrete të mallrave dhe shërbimeve, të cilat do të prokurohen nëpërmjet marrëveshjes kuadër, përcaktohen sipas udhëzimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik.

Në këtë rast Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara ka këto detyra dhe përgjegjësi: a) Të zhvillojë procedurat e prokurimit deri në nënshkrimin e marrëveshjes kuadër; b) Të përllogaritë fondin limit për mallrat dhe shërbimet që do të prokurohen; c) Të shqyrtojë ankesat e operatorëve ekonomikë deri në shpalljen e njoftimit të operatorëve të suksesshëm.

Në Vendimin nr. 400 datë 14.5.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 82 datë 14.2.2018 të Këshillit të Ministrave “Për ngarkimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqëndruara për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të kryeministrit, ministrive dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra dhe shërbime”, në pikën 6 përcaktohet si vijon: “Në pikën 7 bëhen këto ndryshime dhe shtesa: a) shkronja “b” dhe “c” ndryshohen si më poshtë vijon: b) Të përllogaritë fondin limit për sasi të pritshme të mallrat dhe shërbimet që do të prokurohen, bazuar në kërkesa, afatin e marrëveshjes kuadër dhe fondin limit të dërguar nga autoritetet kontraktore. c) Të shqyrtojë ankesat e operatorëve ekonomikë. b) pas shkronjës “c” shtohen shkronjat “ç” “d” dhe “dh” me këtë përmbajtje: ç) të bashkërendojë punën me autoritetet kontraktorë, për mbledhjen e përpunimi e të dhënave teknike e sasiore, të mallrave dhe shërbimeve të vazhdueshme dhe/ose të unifikuara; d) të verifikojë përputhshmërinë e kërkesave të dërguara nga autoritetet kontraktore, me legjislacionin dhe standartet në fuqi, dh) të njoftojë autoritetet kontraktore që të lidhin një ose disa kontrata, sipas nevojave të tyre, brenda afatit dhe fondit të përcaktuar në marrëveshjen kuadër”.

Në dokumentat e tenderit, në “Njoftimin e kontratës”, në pikën 2.7. “Autoriteti kontraktor/Autoritetet kontraktore të cilat do të lidhin marrëveshjen kuadër”, përcaktohet: “Organi qendror blerës në emër dhe për llogari të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve Tiranë”.

Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik sqarojmë se autoriteti kontraktor përfitues dhe me të cilin do të lidhet kontrata/kontratat do të jetë Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

[...]

Organi qendror blerës ka vendosur kriterin në zbatim të nenit 27 pika 8 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar në të cilin është përcaktuar qartë se për autoritetin kontraktor Drejtoria e Përgjithshme të Burgjeve lidhur me mallrat objekt prokurimi të ndalohet të kualifikohen operatorët ekonomikë që janë fitues dhe / apo kanë në proces, në të njëjtën kohë si kontraktorë sipas një kontrate apo kontratave të lidhura a në proces për t’u lidhur, për furnizimin /blerjen e ushqimeve të freskëta në subjekte të tjera shtetërore, të cilat në çastin e hapjes së ofertave nuk i ka përfunduar kontratat në masën 70 %. Gjithashtu për organin qendror blerës është e rëndësishme shmangia dhe evitimi i problemeve që mund të hasen me furnizimet e artikujve të cilat mund të lindin nga mosrealizimi me sukses i kontratave të tjera që operatori ekonomik mund të ketë në proces gjatë realizimit të kontratës objekt prokurimi. Deklarimi i pasjes ose jo të kontratave në proces është kërkuar për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës, të cilët në çdo rast, duhet të plotësojnë deklaratën nën përgjegjësinë e tyre mbi pasjen ose jo të kontratave në proces.

Sa më sipër operatori ekonomik duhet të dorëzojë vetëdeklarimin duke deklaruar që aktualisht nuk ka kontrata të realizuara në masën nën 70% në mënyrë që autoriteti kontraktor t'i lindë e drejta e verifikimit mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik”.

III.1.3. Në nenin 1 “Objekti dhe Qëllimi” të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se:

1. *Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet kontraktore.*
2. *Qëllimi i këtij ligji është:*
 - a) *të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;*
 - b) *të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
 - c) *të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
 - ç) *të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
 - d) *të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
 - dh) *të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.1.4. Në nenin 20 “Mosdiskriminimi” të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet se: *“Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre”.*

III.1.5. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” e ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *“[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese [...]”*

b) *aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, reputacionin dhe besueshmërinë, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.*

Në nenin 46 pika 2 e ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : *“[...] Autoriteti kontraktor mund të kërkojë edhe certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit.[...]”*

III.1.6. Në nenin 27 “Kontrata e Mallrave” pika 8 të Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014 të Këëshillit të Ministrave “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet se: *“8. Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve ndalohet të kualifikojë operatorët ekonomikë, që sipas LPP, janë fitues dhe/apo kanë në proces, në të njëjtën kohë, si kontraktorë/nënkontraktorë sipas një kontrate apo kontratave të lidhura a në proces për t'u lidhur, për furnizimin/blerjen e ushqimeve të freskëta në subjekte të tjera shtetërore, të cilat në çastin e hapjes së ofertave nuk i ka përfunduar kontratat në masën 70%. Përcaktimi i mësipërm vlen edhe për rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ku secili prej tyre, për t'u kualifikuar duhet të ketë përfunduar kontratat në masën 70% të vëllimeve të përgjithshme të furnizimeve, që ai ka marrë përsipër të realizojë, në përputhje me kontratën e bashkëpunimit”.*

III.1.7. Në dokumentat e tenderit, në seksionin “Njoftimi i kontratës”, pika 2.7. është përcaktuar: *“2. 7 Autoriteti kontraktor/Autoritetet kontraktore të cilat do të lidhin marrëveshjen kuadër: Organi Qëndror Blerës në emer dhe për llogari të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Tiranë”.*

III.1.8. Referuar sa më sipër, ashtu siç edhe autoriteti kontraktor informon, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, në rastin konkret, bazuar në legjislacionin si më sipër cituar, me kryrjen e procedurave të prokurimit ku përfshihet dhe blerja e bukës për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, do të kryhet në emër për llogari të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve nga ana e Agjencisë së Blerjeve të Përqëndruara, pra ky autoritet DPB nuk është më në rolin e autoritetit kontraktor pasi këtë tagër përta i përket procedurave të prokurimit e ka marrë Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara, e cila zhvillon procedurat në cilësinë e një organi qendror blerës, cilësi këto të përcaktuara me vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave. Në këto kushte, Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara nuk mundet të anashkalojë përcaktimin e bërë në nenin 27 pika 8 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, pasi ajo në këtë rast ka marrë rolin e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

Rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e ankimuesit “Së dyti, nëse autoriteti kontraktor i qëndron kërkesës së saj duhet të argumentojë kundërshtimin me VKM si dhe të shpjegojë operatorët ekonomikë nëse në rastin e pandemisë dhe izolimit do të konsiderohet kontratë e realizuar periudha në të cilën nuk është ofruar furnizim për autoritete përkatëse, kjo e vërtetuar më vërtetime të lëshuara nga autoritete përkatëse sipas të cilave kontrata nuk është realizuar si pasojë e pandemisë dhe mbylljes së institucioneve nga shpallja e gjendjes së fatkeqësisë natyrore bazuar në VKM nr. 243, datë 24.03.2020 “Për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme”, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se sa më sipër, autoriteti kontraktor, duhet të bëjë sqarimet dhe shpjegimet përkatëse, lidhur me faktin që çdo operator ekonomik i interesuar për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, të jetë i qartë në lidhje me kriteret dhe mënyrën e plotësimit të tyre, duke bërë transparente edhe mënyrën e plotësimit të dokumentacionit për kontratat e realizuara ose në proces, që në këtë rast është specifike në varësi të llojit të procedurës.

III.2.1. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, është ky i fundit organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kriteret që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Rrjedhimisht autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret dhe specifikime teknike në lidhje me produktin e kërkuar, por pa përcaktuar kriteret të tilla të cilat janë diskriminuese dhe përjashtuese nga pjesëmarrja në procedurë të operatorëve ekonomikë të interesuar.

Në asnjë moment autoriteti kontraktor nuk duhet të vendosë kriteret apo të hartojë specifikime teknike të paqarta e konfuze, duke u bërë kështu përjashtues për operatorë të tjerë për një konkurrencë të hapur e të gjerë, bazuar kjo në përcaktimet e legjislacionit për prokurimin publik si më sipër cituar.

Rrjedhimisht autoriteti kontraktor duhet të bëjë sqarimet e shpjegimet përkatëse në lidhje me këto pretendime dhe t’i publikojë ato në përputhje me përcaktimet e ligjit dhe rregullat e prokurimit publik.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Kadra” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF-73393-09-29-2020, me objekt “*Blerje bukë gruri për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve*”, me fond limit 166.020.047 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 23.10.2020, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara.
2. Autoriteti kontraktor të bëjë sqarimet përkatëse për dokumentat e tenderit dhe të publikojë ato në sistemin e prokurimeve elektronike në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Kadra” sh.p.k.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1279 Protokolli,

Datë 14.10.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri